



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 237 prot.

Fushë-Arrëz, më 29. 01. 2025

VENDIM

Nr. 1, datë 27. 01. 2025

PËR

MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR I BLOK-NDIHMËS EKONOMIKE I 6% PËR MUAJIN DHJETOR 2024 PËR NJËSITË ADMINISTRATIVE : FUSHË-ARRËZ, IBALLE, QAFË-MALI , BLERIM DHE FIERZË.

Në zbatim të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore:", i ndryshuar, neni 24, ligjit nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", VKM nr.597.datë 14.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe të përdorimit të fondit shtesë, mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", VKM nr.85.datë 10.02.2021 "Për një shtesë në vendimin nr.597. datë 4.9.2019 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike, dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", Udhëzimit të Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë nr .5, datë 17.02.2017 "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%", i ndryshuar , VKM nr.868. datë 29.12. 2021 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr 597. datë 04.09.2019 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe të përdorimit të fondit shtesë mbi fondet e kushtëzuara për ndihmën ekonomike", VKB nr.2, datë 26.01.2022 "Për miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6%", VKM nr.159. datë 12.03.2022 "Për mbështetjen financiare të disa kategorive të veçanta për zbutjen e pasojave të ndikuara nga lufta në Ukrainë", **Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e tij të datës 27.01.2025**, pas shqyrtimit të propozimeve të paraqitura nga administratorët e ndihmës ekonomike të Bashkisë Fushë-Arrëz:

VENDOSI

Të miratojë listën e përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok- ndihmës ekonomike deri në 6 % për muajin Dhjetor 2024 për, **33** familje me një fond prej **124,833** lekë qe rrjedh nga fondi i përgjithshëm i ndihmës ekonomike prej **2,080,561** leke, dhe shuma për t'u shpërndarë për përfituesit e 6% ne vlerën **122,450** lekë të shpërndare sipas Njësive Administrative:

NJËSIA ADMINISTRATIVE QENDËR FUSHË-ARRËZ

Përfitojnë ndihmë ekonomike të plotë nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike i 6% për muajin Dhjetor 2024, 17 familje me një fond 59,844 lekë.

NJËSIA ADMINISTRATIVE IBALLE

Përfitojnë ndihmë ekonomike të plotë nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike i 6% për muajin Dhjetor 2024, 5 familje me një fond 20,136 lekë.

NJËSIA ADMINISTRATIVE FIERZË

Përfitojnë ndihmë ekonomike të plotë nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike i 6% për muajin Dhjetor 2024, 2 familje me një fond prej 6,752 lekë.

NJËSIA ADMINISTRATIVE QAFË-MALI

Përfitojnë ndihmë ekonomike të plotë nga fondi i kushtëzuar i bllok -ndihmës ekonomike i 6% për muajin Dhjetor 2024, 5 familje me një fond 17,702 lekë.

NJËSIA ADMINISTRATIVE BLERIM

Përfitojnë ndihmë ekonomike të plotë nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike i 6% për muajin Dhjetor 2024, 4 familje me një fond 18,016 lekë.

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administrata e Bashkisë.

Vendimi u miratua nga Këshilli Bashkiak me:

12 vota pro

0 vota kundër

0 vota abstenim

Zbardhur, më 29. 01. 2025.

SEKRETAR

Naze SELIMAJ



KRYETAR

Nikolin BARDHOKU

